



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot. 244

Tiranë, 24 mars 2022

Vendim nr. 18 datë 24.03.2022

Për ngritjen e jurisë së konkursit për çmimet shkencore kombëtare që jepen nga Akademia e Shkencave

Në zbatim të vendimit nr. 14 datë 18.02.2021 të Kryesisë Për organizimin e konkursit për çmimet shkencore kombëtare që jepen nga Akademia e Shkencave; si dhe të vendimit nr. 39, datë 23.06.2021 për një ndryshim në vendimin sipërcituar; Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 23.03.2022, vendosi:

1. Të ngrihet juria për organizimin e konkursit për çmimet shkencore kombëtare që jepen nga Akademia e Shkencave, shpallur me vendimin nr. 14 datë 18.02.2021, me këtë përbërje: akad. Muzafer Korkuti, kryetar; akad. asoc. Mimoza Hafizi, anëtar; akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj, anëtar; akad. asoc. Kozeta Sevrani, anëtar; akad. asoc. Adrian Civici, anëtar; prof. dr. Aljula Jubani (UT), anëtar; prof. dr. Ali Jashari (UK), anëtar; prof. dr. Mimoza Priku (USH), anëtar; dr. Mariglana Meminaj, anëtar (UV).
2. Për mbajtjen e komunikimit zyrtar dhe për funksionet e sekretarisë caktohen sekretaret teknike të seksioneve.
3. Juria të bëjë mbledhjen e saj të parë brenda datës 10 prill 2022.
4. Të ripublikohen në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe në rrjetet e saj sociale vendimi nr. 14 datë 18.02.2021 dhe *Thirrja për pjesëmarrje* nr. 132/1 prot. datë 18.02.2021, në të cilën pikat 1.a, 1.b dhe 1.d) dhe pika 2 mbeten në fuqi.
5. Ceremonia e dhënies së çmimeve fituesve të konkursit të zhvillohet sipas pikës 3 të vendimit nr. 39 datë 23.06.2021, kuadër të 50-vjetorit të

themelimit të Akademisë së Shkencave, me të njëjtën procedurë dhe me të njëjtat kërkesa si në vendimin nr. 14 datë 18.02.2021.

6. Juria gëzon të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetarët e seksioneve, juria dhe sekretari shkencor.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI


KRYETAR

